


TË DREJTAT TONA



E dua
Demokracinë



6 YJET E KUVENDIT

DION (10), ELISA (10), ALBIONA (10), ANESA (10), ERBLIN (10), JONA (10), RINESA (10), FLORINDA (10)



Kuvendi dhe roli ynë në demokraci

Në vendin tonë ka demokraci dhe paqe. Ndërkaq, institucioni më i lartë demokratik është Kuvendi. E pikërisht, Kuvendi është tema të cilën grupi ynë e ka diskutuar sot në "Demos-ti".

Ne e kuptuam se Kuvendi ka një rol shumë të rëndësishëm në jetën tonë. Ju mund të pyesni pse? Deputetët të cilët punojnë në Kuvend, e që me numër janë 120, detyrë kryesore e kanë të kujdesen për mirëqenien tonë. Kjo për shkak, se ne qytetarët jemi ata të cilët i zgjedhim deputetët me anë të votës tonë. Kurse, deputetët mund të ndikojnë në jetën tonë me anë të ligjeve që ata i miratojnë në Kuvend.

Marrim shembull, një ligj i cili miratohet nga deputetët dhe që të bëjë me arsimin, do të ndikojë patjetër në jetën tonë. Nëse ligji thotë se ne duhet të qëndrojmë në shkollë që nga orën 7 e mëngjesit, deri në ora 7 pasdite, ne duhet ta respektojmë atë. Pra, ligjet që miratojnë deputetët janë me ndikim në jetën tonë.

Kuvendi ka tri funksione kryesore: funksionin legjislativ, e që është pikërisht miratimi i ligjeve, funksionin kontrollues, ku Kuvendi e kontrollon Qeverinë, si dhe funksioni i tretë është funksioni përfaqësues, ku Kuvendi na përfaqëson neve, sepse deputetët njihen si përfaqësuesit tanë.

Është shumë e rëndësishme ta dijmë se në Kuvend ka barazi. Pasi Qeveria e dërgon një projektligj në Kuvend, e dijmë se deputetët e votojnë atë. Por, në rast

se 20 nga deputetët të cilët i takojnë komuniteteve jo shumicë, nuk janë prezent në njërin nga seancat ku votohen disa projektligje të caktuara, atëherë projektligji nuk miratohet. Madje edhe në rast se 100 deputetët e kombit shqiptar e votojnë atë projektligj, prapë nuk kalon. Për këtë arsye ne e kemi emëruar artikullin tonë „6 yjet e Kuvendit“.

6 yjet në flamurin tonë, simbolizojnë komunitetet jo shumicë, që janë pjesë e jona.

Pra, të fillë duhet të jemi edhe ne në jetën e përditshme dhe duhet ta kuptojmë se të gjithë jemi të barabartë. Para ligjit edhe ne qytetarët jemi të barabartë me deputetët. Këtë barazi na e ofron demokracia. Pas pak, ne do të kemi mundësi ta vizitojmë Kuvendin dhe të ulemi ne ulëset e deputetëve.

Ne jemi shumë të lumtur për këtë fakt, sepse e kemi kuptuar se Kuvendi është shtëpia jonë dhe ne ndjehe mi të lirë ta vizitojmë atë.



Gazetarët e artikullit

UDHËHEQJA E POPULLIT

ANITA (10), FATLUMI (10), ARLINDA (12), ALBION (11), BLINERA (11), VALMIRE (10)

Demokracia është formë e udhëheqjes ku ne vendosim për të ardhmen e shtetit tonë

Ne si qytetarë kemi të drejtën e të shprehurit lirshëm pa dallim feje, race, komuniteti, gjinie, moshe etj. Në demokraci të gjithë qytetarët jemi të barabartë.

Të jemi qytetarë të një komuniteti do të thotë të kemi të drejta dhe obligime për vendin ku jetojmë. Në demokracinë e sotme, të gjithë qytetarët përfshirë edhe ne fëmijët, kemi plot të drejta, të cilat i gëzojmë.

Elementet e demokracisë janë: respekti, barazia, dashuria, liria, toleranca, shprehja e lirë e mendimit etj. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje, që nënkupton se qeverisja i takon popullit.

Ekzistojnë shumë lloje të demokracisë por dy prej tyre më të përhapurat janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese.

Përfaqësuesit e një vendi janë deputetët.

Përfaqësuesit apo deputetët e shtetit duhet t'i kenë disa vlera dhe disa cilësi si për shembull: të kenë dashuri për atdheun dhe popullin, të kenë aftësi komunikative, të jenë fleksibil dhe transparent, të përfaqësojnë interesat e popullit dhe t'i zbatojnë sa më shumë elementet e demokracisë.


Në shtetin tonë Kosovën, ekziston demokracia përfaqësuese parlamentare, ku populli i voton deputetët të cilët zgjedhen përmes votës së lirë të qytetarëve. Të gjithë qytetarët e Kosovës kemi të drejtë të votojmë lirshëm mbi moshën 18 vjeçare.

Pra, në demokraci, të gjithë jemi të lirë dhe të barabartë, por kjo nuk do të thotë se në shoqërinë demokratike nuk ka rregulla dhe ligje, sepse ato janë pjesë e pandashme e jona dhe duhet t'iu përmbahemi atyre në mënyrë që të kemi një jetë sa më të mirë.



Çka do të thotë fjala demokraci?


Fjala demokraci do të thotë qeverisje apo udhëheqje e popullit



E drejta e votës së lirë



Edhe pse jemi të ndryshëm ne punojmë së bashku



Vota është shumë e rëndësishme në demokraci. Përmes votës ne e vendosim të ardhmen e vendit tonë



Jemi të lirë si flutura



Jemi të barabartë



Ne sot në projektin "Demos-ti", kemi mësuar shumë gjëra për demokracinë dhe rolin e saj në jetën tonë

VOTA E LIRË DHE E FSHEHTË


OLTI (10), HARIS (10), ORGES (10), ELIONA (10), ELMEDINA (11), GENTIANA (11), LEONITA (10)

Sot në punëtorinë e demokracisë u bëmë gazetarë të Kuvendit të Kosovës. Pas disa aktiviteteve u ulëm dhe biseduam për zgjedhjet. Më poshtë do të lexoni se çfarë mësuam ne

Vota e lirë shprehet kur qytetarët e një vendi mbi moshën 18 vjeçare votojnë për përfaqësuesit e vendit të tyre. Zgjedhjet janë procesi ku njerëzit dalin dhe votojnë për të preferuarit e tyre. Në Kosovë, kemi zgjedhje lokale (komunale) dhe zgjedhje qendrore (parlamentare). Në Kuvendin e Kosovës janë 120 deputetë. 100 prej tyre janë pjesëtarë të kombit shqiptar, dhe 20 prej tyre i përkasin komuniteteve jo shumicë të Kosovës. Zgjedhjet lokale janë ato zgjedhje ku zgjedhet kryetari i komunës dhe asambleja e saj. Zgjedhjet parlamentare dhe komunale mbahen çdo 4 vite. Ne mendojmë se një përfaqësues i mirë ka këto cilësi: është shtetas i Kosovës, ka aftësi intelektuale dhe është i dashur me popullin dhe qytetarët e tij. Edhe pse ne nuk jemi 18 vjeç, ne ju ftojmë të votoni edhe ju.




Gazetarët yje




Kosova është një shtet demokratik



Votat tona janë të fshehta



Të gjithë ne jemi të lirë të zgjedhim



Vendi ku vendosen votat tona



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Zenel Hajdini“
Klasa: 5-6
Vendi: Prishtinë